



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2019:201957
Datë: 21.11.2022
Numri i dokumentit: 03668211

C.nr.38/17

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Betim Behluli si dhe më Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina në çështjen juridike të paditësit M. B. nga fshati Arllat, Komuna e Glllogocit i përfaqësuar nga Av. F. M. nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, sipas bazës juridike kompenzim i dëmit material, me datën 21.11.2022 merr këtë:

A k t v e n d i m

Konstatohet e tërhequr padia e paditësit M. B. nga fshati Arllat, Komuna e Glllogocit, e parashtruar kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë me të cilën ka kërkuar kompenzimin e dëmit material.

A r s y e t i m

Paditësi M. B. nga fshati Arllat, Komuna e Glllogocit, përmes të autorizuarit të tij Av. F. M. nga Prishtina ka parashtruar padi kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “S.” me seli në Prishtinë, sipas bazës juridike kompenzim i dëmit material.

I autorizuari i paditësit me datë 18.07.2022 me parashtrësë e njofton gjykatën se e tërheqë padinë të parashtruar pranë kësaj gjykate, duke theksuar ndër të tjera se paditësi e ka realizuar kërkesën në procedurë jashtëgjyqësore.

Meqenëse i autorizuari i paditësit përmes parashtrësës e ka tërhequr padinë, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi konform nenit 261, par.1 dhe 3 të LPK-së.

Gjykata Themelore Gjakovë-Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm.
C.nr.38/17 me dt. 21.11.2022

Gjyqtari
Betim Behluli

Këshillë juridike: Kundër këtij Aktvendimi në kuptim të nenit 261 par.4 të LPK-së nuk lejohet e drejta në ankesë.